



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:295879

Datë: 20.12.2024

Numri i dokumentit: 06634384

C.nr.807/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë të paditësve: A.M, nga fshati Ratkoc, Komuna e Rahovecit, A.S nga fshati Rakovinë, Komuna e Gjakovës, A.M-H nga Gjakova, B.K nga Prizreni, dhe E.B nga fshati Dejnë, Komuna e Gjakovës, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av. D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit e pa përcaktuar, jashtë seancës, me datë 20.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësve: A.M, A.S, A.M-H, B.K, dhe E.B, ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, në çështjen juridike kontestimore C.nr.807/2024.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit A.M, A.S, A.M-H, B.K, dhe E.B, pranë kësaj gjykate me datë 26.08.2024, përmes përfaqësuesit të autorizuar Av. D.M nga Prizreni, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike - kompensimi nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit e pa përcaktuar.

Kjo gjykatë me Aktvendimin C.nr.807/2024 të datës 28.10.2024, i ka ftuar paditësit që në afat prej 3 ditëve nga dita e marrjes së aktvendimit, ta përmisojnë dhe plotësojnë padin, ashtu që ta përcaktojnë saktë periudhën kohore për të cilën kërkojnë kompensim, si dhe shumën e kërkuar, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e precizojnë – përmisojnë, do të konsiderohet se e kanë tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletë kthesa se përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, me datën 07.11.2024, e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka precizuar – përmirësuar padinë sipas aktvendimit të gjykatës.

Sipas nenit 102.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë”*.

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësit nuk e kanë bërë precizimin dhe plotësimin e padisë brenda afatit të përcaktuar, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 102.3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.800/2024, me datë 20.12.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.